

GIULIA BESA
DJALI I KEQ QË UNË DASHUROJ

ROMAN

BOTIMET TOENA

GIULIA BESA

DJALI I KEQ QË UNË DASHUROJ

Roman

Përktheu nga origjinali italisht

Eris Rusi

BOTIMET TOENA

Tiranë

Autori: Giulia Besa (Xhulia Beza)
Titulli në origjinal: Il ragazzo cattivo che amo
Botoi në italisht: Rizzoli libri

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi
Redaktore letrare: Besa Vila
Korrektore letrare: Majlinda Bami
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817723

© 2019 Giulia Besa
Ky libër është botuar me marrëveshje me Agjencinë
Letrare Loredana Rotundo, Milano, Itali.
© në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420
E-mail: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al/>

Për Andrean, shkrimtarin tim të parapëlqyer,
me të cilin kam dëshirë të jetoj përgjithmonë.
Të dua, i shtrenjti im. Ke dëshirë të martohesh me mua?

#trëndafila #gjemba #yshjedjali

Më hapet goja dhe i çel sytë ngadalë. Trëndafili, që lulëzon në kraharorin e Çezares, të mrekuillon. Lulja e pikturuar në lëkurën e bardhë, pranë zemrës, është gjithë jetë dhe ngjyra e theksuar e petaleve e zbeh tatuazhin e dikurshëm të gjembave.

E kaloj gishtin mbi formën e trëndafilin, duke ndjekur formën e lules përgjatë kraharorit gjithë muskuj të të dashurit tim. Gjatë vitit të fundit, më ndodh gjithmonë e më shpesh të zgjohem me dorën mbi gjoksin e tij dhe me gishtat e lëshuar mbi lulen e kuqe.

Një bori makine së largu, më shtyn të hedh sytë drejt dritares. Një puhi e freskët lëkund grilat gjysmë të mbyllura. Më hyjnë dridhmat dhe mblidhem pas Çezares; e ngjesh trupin lakuriq pas ijëve të tij. E për siguri, futem më thellë nën kuvertën e bardhë. Ledhat nuk prishin punë asnjëherë.

Ai gërhet i qetë, i shtrirë në kurriz dhe pas dashurisë së papërmbajtur natën që sapo lamë pas, nuk do të zgjohej as po të futeshin “Iron Maiden” në dhomë për një koncert surprizë.

E admiroj fytyrën e shtendosur të tij, të zhytur në jastëkun me pupla rose - e megjithëse kemi fjetur shumë herë bashkë, më duket ende qesharake që të dashurin tim plëngprishës nuk e kap dot gjumi po s'pati poshtë koke jastëkun më të butë të shtëpisë. Flokët e zinj dhe me shkëlqim si sipërfaqja e lumit Tevere gjatë natës, hapërdahen mbi këllëfin e bardhë dhe formësohen si kornizë mbi fytyrën ende të lodhur. Nuk e di në ç'orë na kapi gjumi të dyve, por rrezet e para të ditës kishin depërtuar në dhomë atëherë.

Kafshoj cepin e buzës. Mirë, fjetëm pak, por unë kam prapë dëshirë që të bëj dashuri. Pa zënë në gojë pastaj që nuk dua të rri e vetme me shqetësimet e mia. Edhe pak ditë mbeten nga provimi hyrës në Degën e Veterinarisë dhe ka nisur të ndihet stresi. Po të mos më shkojë mbarë për të dytën herë radhazi... Jo, nuk duhet ta çoj ndër mend këtë gjë, përndryshe do të më vijë në fyt shampanja që rrëkëllyem mbrëmë. E marrtë dreqi, dje nuk duhej të kisha pirë, duhej të kisha lexuar. E ta mendosh që në gjimnaz isha e para e klasës. Asgjë nuk më shpërqendronte dot, po ta ndaja mendjen të përqendrohesh në librat e shkollës. Po si t'i bëj dot ballë Çezares?

I kaloj sërish gishtat mbi hijezimin e trëndafililit, kësaj here me thonj. Çezare murmurit diçka dhe përqark gishtave të mi shfaqen mornica. Buzëqesh me vete dhe zbres dorën përgjatë trupit të tij. Më vjen keq për të, por duhet ta zgjoj.

Çezare kthehet nga ana ime e më buzëqesh. O Zot, kur i shoh gropëzën që i formohet në faqe, ky është momenti më i bukur i ditës. Apo më mirë të themi, momenti i dytë më i bukur pas...

- Mirëmëngjesi, - më përshëndet me zërin ende të zvergur nga gjumi. E zgjat krahun dhe ma vendos pas kokës, që të më tërheqë pranë vetes. Më puth dhe buzët e tij kanë shijen e vetes sime. Ky mendim më skuq, megjithëse tanimë ai më ka shijuar me dhjetëra herë.

- Ta njoh atë vështrim dinak, - më thotë. - Më zgjove se ke dëshirë ta bëjmë përsëri.

- Ç'është e vërteta, doja të të lija shenjë.

E prek me gishtërinj njollëzën e kuqe mbi qafën e tij, afër venës së rrethuar me gjembaçë.

- Shenja që të lashë dje po fshihet, e nuk dua që kur të dalësh prej këtu, ndonjëherë t'i shkojë mendja gabimisht që nuk je i lidhur.

- Edhe e jotja ngjan se po fshihet. - Çezare më zhbiron shpatullat me sytë e zinj. - Është e nevojshme të të kafshoj prapë.

- Çfarë thua, pak më parë isha në tualet dhe kafshimi yt duket akoma shumë mi...

Çezare më hidhet përsipër dhe i ngul dhëmbët mbi shpatull. Por është një kafshim i ëmbël, një kafshim dashurie. Është simboli i dëshirës që të më ketë të tijën. Çezare më shtrëngon pas vetes, thith lëkurën në harkimin mes qafës dhe shpatullës, duke lënë shenjën e tij. E di mirë ç'formë do të ketë, do t'i ngjajë petalit të trëndafilin.

Gjuha e tij më ngacmon e më kapin dridhmat, dhe një ndjesi e njohur vale në fundbark më nxit dëshirën të shtyhem pas tij dhe të harroj gjithçka.

Por shkon për drejt gjithçka, po ta harroj provimin. Po të harroj që duhet të studioj. Nuk dua të ripërsëritet drama e vitit të kaluar: kur mësova që nuk ia dola dot të futesha në shkollën e veterinarisë m'u përmbys bota. Ishte turpërimi më i hidhur shkollor që kam përjetuar ndonjëherë. Nuk mjaftuan as tri darka rresht ku u shqepa me *McDonalds* që të vija në vete.

Edhe mamaja mbeti e zhgënjyer. U përmbajt që të mos ma vinte në dukje më tepër dhe u tregua mirëkuptuese, u përpoq të më jepte zemër që të mos hiqja dorë e ta provoja përsëri, por thellë-thellë dukej që i kish ardhur keq. Ajo do më çdo kusht që unë të bëhem veteriniere, ashtu si pat qenë edhe babai. Nuk mund ta përballoj dot përsëritjen e një sprove dështuese të tillë.

- Ej! - Çezare heq mënjanë një tufëz flokësh nga fytyra, pastaj më jep një puthje të lehtë në buzë.

- Ç'të gjeti? Krejt papritur u vrenjte në fytyrë.

E shkëput vështrimin prej tij dhe nis vrojtoj perdet e dymve të ballkonit që lëkunden nga era. Kam përshtypjen që po të dilja e të zgjatesha nga ballkoni, nëse do të zgjasja dorën jashtë, do të arrija të cikja grilat e dritareve të pallatit përballë, aq afër e kemi. Kjo, edhe pse parapëlqej të mbështet bërrylat mbi parvaz dhe të vëzhgoj njerëzit që lëvizin lart e poshtë rrugës "Corso" . Më çlodh kjo gjë.

- E ke nga provimi? - më pyet Çezare.

E rikthej vëmendjen tek i dashuri.

Ai më zhbirilon me sy.

- Nuk ke dëshirë të flasësh?

Kafshoj buzën: - Jo!

- Nuk të bie në qafë, nëse të duhet të lexosh!

Çezare më shikon serioz, por brenda vështrimit të tij ka ende pakëz gjurmë ngacmimi për fat të keq.

- Do të bëhem djalë i mbarë, ta premtoj!

- Posi. Siç ishe dje, pardje, mbipardje...

- Sot do të dal. Kështu s'do të bie në ngasje. Do të shkoj te kontabilisti.

- Na e mbushe mendjen, do të shkosh të dielën te financieri ti!

- Eh, por po të përfytyrova këtu, të ulur këmbëkryq mbi shtrat, me librin në prehër, që të prek të brendshmet prej dantelle, e po ta kesh edhe fytyrën e përqendruar siç je kur studion, e po të mos i kesh të vëna as sytjenat...

Mbushem thellë me frymë.

- E di, e di, ti zhytesh në imagjinatë e pastaj duhet që të më ngacmosh.

Çezare qesh. Ai nuk është se shpërthen ndonjëherë në gaz, por e qeshura e tij zëulët e drithëruese ka fuqinë të më përfshijë të tërën. Nuk është më ajo buzëqeshja gjysmake e djaloshit të keq, por është buzëqeshje e vërtetë. Më afrohet dhe e mbështet dorën në ijët e mia, një gjest që tregon se më ka të tijën dhe që unë e adhuroj. Jemi vetëm ne të dy në shtëpi - hmm, me

përjashtim të Shëmtaraqit, maçokut të tij - por që do prapëseprapë ta ruajë në çdo kohë kontaktin me mua. Ta ndiejë që jam e tija.

E ngre vështrimin nga dora te fytyra e tij, e pastaj poshtë, përgjatë trupit të mrekullueshëm. Stërvitja e boksit bën që muskujt e tij të jenë të dukshëm edhe kur nuk janë të tendosur. Venat që i përhapen në krahë i përngjajnë atyre statujave prej mermeri këtu në sheshin “Popolo”. Ndërsa vena në qafën e skalitur ma heq mendjen fare. Mëkat për gjembat e zinj që e mbajnë burgosur, teksa ngjiten nga kraharori drejt fytit.

Tatuazhi i ferrave nis nga ija e djathtë dhe e mbulon kraharorin e të dashurit tim, duke u zgjeruar deri në anën tjetër të shpatullës. Një pyllnajë gjembash mbulon muskujt, e kushdo vajzë tjetër do të stepej që të afronte buzët, aq real ngjan ai vizatim. Por jo unë. Unë nuk pata frikë mos shpohesha, përkundrazi jam krenare që mes ferrave çelën gjithë ato trëndafila.

Dymbëdhjetë trëndafila. Çezare festoi çdo muaj të lidhjes sonë, duke bërë tatuazh nga një trëndafil të ri. Dhe lulet, njëra pas tjetrës, do ta fitojnë betejën me gjembat.

Por... E zgjat dorën kah ijëve të të dashurit, pikërisht atje ku zënë fill gjembat. Atje ka një njollë të madhe të errët, që nuk është pjesë e tatuazhit. Çfarë të jetë? E mavijosur vallë?

I hap buzët për ta pyetur ku e ka marrë një goditje të tillë, por vështrimi kryqëzohet me të tijin, e kështu ngrij në vend.

- Do që ta provosh pak?

- Si?

Çezare ngërdheshet.

- Mu duk sikur doje që të studioje, por po më ha me sy tani!

Në faqe i formohet sërish një gropëz, e mua më pushton dëshira. Fryma që del prej tij më ngacmon, ka aromë luleshtrydheje, ka shijen time.

- Je njeri i tmerrshëm, që kënaqet duke marrë më qafë studentet.

Çezare më kap dorën që e kisha ngritur drejt shenjës së mavijosur dhe e çon në gojën e tij. E thith majën e gishtit tregues. O Perëndi! Ai e di mirë që kur sillat kështu, më turbullon fare. E di dhe përfiton nga kjo. Harron fare që duhej të më linte të studioja për provimin e pranimit.

- Ndoshta ke dëshirë të hash një mëngjes special! - murmurit, pa e hequr gishtin tim nga goja. - Diçka që të të japë energji e ta kesh për gjithë ditën.

- Mjaft!

Por zëri im nuk tingëllon shumë i vendosur. E kuptoj dhe vetë këtë.

Çezare e heq gishtin nga goja dhe përkulet që të më puthë. Më bie në sy që nuk ka vetëm atë mavijosje në ijë. Ka edhe të tjera, të mimetizuara mes gjembave, si dhe një të nxirë shumë të keqe në klavikul, pak më poshtë se muskuli i fryrë i shpatullës. Diku mes gjembave, m'u duk sikur dallova edhe ca të prera që s'kanë shumë që janë shëruar.

- Çezare, po këto si i paske bërë? - prek lehtë shenjat e errëta që bien më tepër në sy. - Të dhembin?

Atij i ngrin buzëqeshja dhe zymtohet në fytyrë. Ngjyra e errët e irisit të syve ngatërrohet me bebëzat.

- S'janë gjë, veç ca goditje që kam marrë në stërvitje.

Edhe mundet. Por e kam parë gjithë ato herë kur stërvitet në ringun e boksit dhe nuk është katandisur asnjëherë kështu.

- Mos vallë je zënë me Lukën, ngaqë do të takohem me të?

- Jo. - Buzëqeshja i rikthehet hareshëm dhe i rishfaqen gropëzat e bukura në fytyrë.

- Por s'e mohoj dot që do t'ia zhysja me grushte hundën në surrat me qejf të madh.

- Ej, e kam shok unë, mos fol ashtu për të.

Çezare ngre shpatullat. Flokët e zinj i bien mbi sy dhe mundohet të marrë një pamje engjëlli. Por nuk e kishte me shaka. Nuk e përtyp dot faktin që unë dhe Luka kemi filluar të takohemi përsëri si shokë.

Amin! Çezare duhet të mësohet me këtë gjë. Mirë, në rregull, Luka është ish-i dashuri im, por mbetet një njeri i sjellshëm e i mrekullueshëm dhe nuk e kuptoj pse duhet të heq dorë nga miqësia e tij vetëm për hir të një xhelozie pa bazë. Veç të tjerash, unë i kam shkaktuar atij shumë vuajtje në të kaluarën dhe nuk është rasti që Çezare tani ta shtyjë gishtin më thellë në plagë.

- Për atë po mendon, - thotë Çezare me zë të ulët dhe me një vështrim të egërsuar. - Por ti duhet të mendosh gjithmonë dhe vetëm për mua.

Një prekje e lehtë me gishta mbi shtresën e pambuktë të mbathjeve. I shtrëngoj kofshët, por dora e Çezares mbetet atje, në mes. Më ngacmon nga sipër cohës, tamam në pikën më të ndjeshme. Me gishtin tregues bën lëvizje rrethore duke e shtypur ngadalë, aq sa faqet më marrin zjarr dhe e humb krejt toruan.

Çezare është një demon që të tundon në mëkat.

- Kuptohet, nëse ke më shumë dëshirë që të studiosh...

Gishti bën të shkëputet nga mbathjet, ndërkohë mua më del një pasthirrmë hidhërimi. E ngre fytyrën dhe i çel buzët, gati për të kafshuar buzët e tij.

Por, para se ta prek, ai shqyen sytë: - Ohh!

Çezare kërcen dhe shkëputet prej meje, duke përfunduar me kurrizin mbi kuvertë: Shëmtaraq!

Maçoku i bardhë - më shumë sesa një maçok, tani i ngjan një pantere, aq shumë është rritur tanimë, kruspullohet për qark këmbës lakuriqe të të dashurit tim dhe ia bllokon me thonj. Me këmbët e pasme i jep ca goditje shputës, e ndërkohë i kafshon gishtin e madh. Shëmtaraq i mban veshët e ngrehur pipëz, ndërsa sytë i ka sy të yshtur nga dreqi vetë.

- Më lësho! - i bërtet Çezare. - Përndryshe do të të rrjep të gjallë!

Bën ta kapë maçokun pas rripit, por Shëmtaraq i çlirohet nga shtrëngimi dhe bëhet gati për një sulm të

ri. I dashuri im fërkon këmbën, ku dallohen shenjat e kuqe të kthetrave.

- Shiko ç'më bëre!

Shëmtraraq i harkon kurrizin, kërcënues, e kështu ngjan edhe më i madh. Dita kur Çezare e gjeti nën një kosh plehrash, pranë shtëpisë sime, duket mjaft e largët. Aso kohe ishte sa pëllëmba e dorës, një topth i vogël me qime, me veshët e ngrehur pipëz. Tanimë, për shkak të të ngrënit pa frena, nga ato për mace ekstra të shtrenjtë që i jep Çezare, është shndërruar në një panterë. Një panterë e klasit të lartë: me gëzofin e bardhë e të shndritshëm, si dhe me pjesët e errëta për qark putrave që e bëjnë të duket sikur mban veshur këpucë elegante. Çezare e përkëdhel si ta ketë fëmijë dhe maçoku ia shpërbleu duke u shndërruar në një ekzemplar të mrekullueshëm felin. Sa keq që me pronarin ka të njëjtën natyrë që priret drejt sherrit.

Shëmtraraq i tund bishtin me pamje sfiduese. Sytë i digjen nga një flakë e gjelbër.

Çezare zgjatet drejt tij. - Ta tregoj unë tani...

Që të dy kacafyten mbi krevat, e janë qesharakë, vërtet.

Rehatohem në bisht për të ndjekur me sy atë skenë. Duhet ta shtupoj gojën me dore që të mos shpërthejë në gaz. Por...

- E marrtë dreqi, dritarja...

Çezare hedh një vështrim pyetës drejt meje. Kjo zgjat veç një çast, pastaj e kupton. Por edhe Shëmtraraq i nuhat që dritarja është e hapur.

I dashuri im kërcen si rrufe nga shtrati, ndërsa maçoku niset me shpejtësinë e erës. Me një kërcim të beftë, Çezare godet me shkelm kanatën e dritares dhe e mbyll mu para hundës së Shëmtaraqit, i cili përplaset pas xhamit. Maçoku e tund kokën i trullosur.

- Sa mirë, kështu do të vësh mend që të mos më biesh në qafë kur ngacmoj të dashurën! - Çezare e merr në krahë maçokun dhe i shkul veshët. - Je xheloz që kam një të dashur kaq të bukur!

Shëmtaraqi i ikën duarsh dhe bie mbi krevat. Zë vend në cep dhe lëpihet me pamje koteleje.

- Po si ia doli që u fut brenda në dhomë? - pyet veten Çezare. - Jam i sigurt që e kisha mbyllur me çelës.

- Ndoshta është përvjedhur kur shkova në tualet gjatë natës.

- Duhet të tregosh më shumë kujdes! E kemi diskutuar edhe më parë këtë gjë.

Çezare ka të drejtë: nuk mund të rrezikojmë që Shëmtaraqi të dalë në ballkon. Një herë rastisi që i joshur nga pëllumbat, për pak sa nuk ra poshtë në përpjekje për t'i kapur fluturimthi. Po të binte nga kati i tretë në trotuar, mund të dëmtohej seriozisht. Poshtë është rruga, makinat...

Kështu që, po, Çezare ka të drejtë që nervozohet. Por mua propësepropë s'më pëlqen kur më qorton, nuk e kam qejf kur më çan kokën. Pa përmendur pastaj që apartamentin e ka blerë ai vetë dhe mund ta kish menduar që do t'i dilnin telashe me Shëmtaraqin.

E tërheq mbulesën e shtratit derisa fsheh kraharorin.

- Ndoshta ka kërcyer në dorezën e derës. Është i zgjuar, do të ketë mësuar ta hapë vetë.

Çezare shtrembëron fytyrën me mëdyshje. Mirë, iu mbush mendja që unë e kam vënë maçokun në rrezik. Punë e tij. E tek e fundit, më vjen për shtat që atmosfera u zbeh, kam për të studiuar.

Ndonjëherë e pyes veten nëse Çezares i intereson vërtet provimi im. Kjo, sepse pas gjithë atyre fjalëve të bukura ose ka qejf vetëm që të kënaqet, të bëjë seks e qejf dhe në djall gjithçka tjetër, ose është i shpërqendruar, i çinteresuar. I përhumbur në mendimet e tij. Nuk do të doja që të kishte probleme për të cilat s'ka dëshirë të më tregojë.

Duhet të këmbëngul dhe ta pyes për mavijosjet në trup. E njoh mirë tanimë dhe e di që nuk më ka thënë të vërtetën. Dhe u soll në mënyrë të tillë që ta ndryshonte qëllimisht rrjedhën e bisedës. Por nëse e ka vendosur të mos më tregojë gjë, është e kotë që të pyes më tepër, s'ka për ta hapur gojën për këtë çështje. Dhe kjo është një sjellje që po më pëlqen gjithmonë e më pak.

E tund kokën. Boll me kaq. Duhet t'i përvishem studimit.

#BFF¹ #shoqjaimebloggeremode

Po pra, posi, të studioj. Do të ish më e thjeshtë po ta përplasja librin në ballë me shpresën që njohuritë të më depërtonin në tru përmes osmozës.

Shfryj e dëshpëruar dhe e vendos librin e biologjisë mbi stolin prej mermeri, pranë këmbëve të kryqëzuara. Për fat kam veshur xhinse të shkurtra, kështu që freskohem nga kontakti me gurin e ftohtë: bën shumë zagushi, të merret fryma, për të qenë ditë shtatori. Ndoshta nuk doli ide brilante të vija të studioja te Villa Borghese në këtë vapë, por nuk mund të qëndroja dot në shtëpi me Çezaren.

Do të më kishte kërcyer përsipër dhe do të kishim përfunduar duke u tundur lart e poshtë në shtrat gjithë pasditen.

1 Best friend forever – miq të ngushtë përgjithmonë (shënim i përkthyesit).

E shkëpus stofin e kanotierës së bardhë nga lëkura dhe i hedh flokët anash qafës. O Zot sa të gjatë më janë bërë! Tashmë më vijnë deri poshtë gjoksit, gati buzë kërthizës. Por të dashurit tim plëngprishës i pëlqejnë kështu, si dallgë të errëta, ndaj jam e lumtur që po i lë të rriten. Megjithëse ma marrin frymën nga vapa.

Forca e lastikut mbajtës, kalon tek unë!

I lidh flokët bisht, e ndërkohë hedh vështrimin për qark. Cepi i Villa Borghese ku zgjodha të ulem të studioj, është i shkretë, me përjashtim të dy indianëve që ruajnë biçikletat me qira dhe rikshat e rreshtuara përgjatë rrugicës me buste prej mermeri. Edhe vetë bustet ngjajnë si në vështirësi për shkak të temperaturës, e jam e sigurt që po të kishin duar do të fshinin me façoleta ballin e djersitur, si indianët e rikshave. S'ka këmbë njeriu që të vijë të marrë biçikleta me qira. Por s'do mend: sot, kush del nga shtëpia ka rrezik t'i bjerë pika veç duke ecur në rrugë, le më pastaj t'i japë biçikletës! Ja, uroj që dielli të më dërrmojë kokën fund e krye: kështu ka për të qenë më e lehtë të më depërtojnë në mendje fjalët e librit!

Jam ende e turbulluar nga të nxirat në trupin e Çezares e nuk arrij të mendoj dot për gjë tjetër. Më ka gënjyer, jam e bindur: gjatë dyluftimeve në stërvitje nuk vritet asnjëherë, e kur rastis, s'janë veçse ca shenja pa rëndësi. Jo të nxira të këtij lloji, sikur të jetë zënë vërtet me grushte me dikë. E për një çast, brenda syve të tij të errët, ridallova sërish melankolinë që e brengoste kur u njohëm vitin e kaluar. U përhap aq sa i turbulloi vështrimin, e ledhat e mia nuk arritën dot që t'ia largojnë.

Kuptohet, ishte veç për një moment, por mua nuk më shpëtoi. Ndoshta shqetësohet për të motrën. Sot në mbrëmje Çezare duhet të shkojë në Firence që të bisedojë me të. Ma zuri në gojë që Simona ka sërish probleme me ushqimin dhe i ati nuk e ndihmon, madje marrëdhënien mes tyre e kanë shumë të tendosur. Çezare është treguar tejet i dhembshur me të motrën, e kjo ndoshta e shpjegon nervozizmin e tij, por ç'drejtin hyjnë të nxirat në këtë mes? Vërtet kanë të bëjnë me një shpërqendrim të tijin gjatë stërvitjes në palestër?

Një puhizë e lehtë, po ajo që këtë mëngjes përkundte tendën e ballkonit, rinisi të më përkujtojë lëkurën e krahëve, e këtë herë kjo gjë sikur më lehtëson. Gjethet e plepave sipër kokës sime luhaten nga fladi. Era sjell me vete edhe muzikën e karuselit të fëmijëve, që e përfytyroj sikur rrotullohet bosh, me makinat lodër dhe me kuajt prej druri të shkretë. Por, tek e fundit, kush nënë do të tregohej aq mizore sa t'i shpinte tani fëmijët në karusel? Rrezik të skuqeshin si vezë pashke vogëlushët!

I mbyll sytë një hop dhe thith aromën e bimëve në lulëzim. Duhet të qetësohem dhe të studioj. Të studioj. Të studioj. Të studioj. E përsërit fjalëzën magjike si një formulë përqendrimi.

- Ja ku na qenka, qullacja e librave e sektorit D!

Është një zë i njohur që më jep një dridhmë kënaqësie. Apo, mos vallë po e ëndërroj?

Zhurme hapash mbi zhavorrin e rrugës. I rihap sytë dhe përpara meje gjendet fytyra e qeshur e Alesandrës. Fytyrën e ka si të futur në kornizë nga

flokët ngjyrë kumbulle. Sytë e kaltër, si të macës *Cheshire*, nguliten mbi mua.

- E dija që do të të gjeja këtu, - më thotë. - Ky ishte vendi yt i parapëlqyer edhe kur studioje për provimet e maturës. Palluqe librash ke mbetur!

E mbledh veten. Jo, nuk është ëndërr.

- S'po më besohet... Ale...

- Unë jam, kokë e këmbë! - dhe ajo më mbështjell në përqaqim. E përqafoj dhe unë. Më ka munguar shumë aroma e vaniljes që lëshojnë flokët e saj.

- Po nga mbive këtu? Kujtoja se e kishe harruar që ke një shoqe të ngushtë. Një mendje më thoshte mos të kishin marrë në emisionin "Ishulli i tundimit"!

- Ah, sikur të ishte e vërtetë kjo!

Shkëputemi nga krahët e njëra-tjetrës, Ale më ulet pranë, duke shtyrë librin e biologjisë. Ka veshur pantallona të tejdukshme, me prerje elegante dhe e vë dorën në zjarr që bluzën e ka nga katalogu pranverë-verë i *Versace*-s. I rri për mrekulli në trupin e saj të hajthëm. Alesandra ka pasur përherë shije të hollë në të veshur, por në këtë rast e ka tejkaluar veten. E mat me sy nga koka te këmbët.

- Brenda katër muajsh qenke shndërruar në modelen Kiara Ferranji?

- Të pëlqen pamja ime e re?

- Mund të rrish fare mirë në një nga ato videot në *YouTube* "Sa kushton veshja jote"!

Qeshim të dyja. Sa e çuditshme është ta dëgjoj të qeshurën e Alesandrës. Kam gjithë atë kohë pa e takuar. Hera e fundit ishte kur dolëm të pinim diçka, e bëhet fjalë para verës, në maj fare, në mos gaboje.

- Megjithatë mund të më kishe shkruar ndonjë mesazh, - murmurit. - E kam seriozisht, mendoja që më kishe hequr nga lista.

- Po ç'janë këto, thjesht kam qëndruar pak larg celularit këto kohë. - Ale i hedh një sy çantës së dorës *Louis Vuitton* që mban në prehër, sikur celulari do t'i kërcente përjashta e do t'i ngulte dhëmbët.

- S'ka ndonjë gjë, - them dhe ngre shpatullat. - Jetohet shumë mirë edhe pa telefonat inteligjentë. Për shembull, nëse je ndonjë murg budist në majë të Himalajës.

- Lëri këto! - Ale qesh përsëri, dhe jam e gëzuar që e shoh të lumtur. Nuk di çfarë e ka mbajtur të zënë gjatë këtyre muajve, por nuk duhet të jetë diçka dhe aq e keqe. Ndoshta një dashuri e re? Përpiqem të mos fut hundët në punët e saj, kur ajo merr librin tim të biologjisë.

E shfleton pa interes.

- Si po shkon me studimet?

- Mirë, le të themi... Pas disa ditësh, më datën 10, do të bëj përsëri provimin e pranimit për veterinari. Shpresoj të shkojë mirë, po të dështoj për herë të dytë, vërtet nuk do të dija çfarë të bëja.

Shprehja e Ales bëhet skeptike. Nuk kuptoj nëse dyshon që unë do ta kaloj provimin, apo nëse dyshon që unë kam frikë vërtet.

- Në korrik dhashë provimin e kimisë, - shtoj, - dhe me këtë më bëhen tri provime të marra. Të paktën nuk e dogja kot krejt vitin.

- Po, më kujtohet që ma ke thënë. Je regjistruar në biologji për të dhënë provimet që janë të përbashkëta me ato të veterinarisë, apo jo?

Pohoj me kokë: - Fiks.

- Ke bërë mirë. Ke qenë gjithmonë shumë e aftë në shkollë dhe nuk duhet të dorëzohesh.

Ale përmbys një faqe tjetër, dhe shfaqen foto të protozoarëve në mikroskop.

- Por je e sigurt që ishte ide e mirë të qëndroje me të?

- Hë? - Sytë më zgjerohen, e habitur. - Po flet për Çezaren?

Ale mbyll librin dhe bën me kokë që po. Po të mos e njihja prej një jete, do të betohesha se po bën shaka. Ishte ajo që më shtyu të ribashkohesha me Çezaren vitin e kaluar!

- Ish ide e shkëlqyeshme. Tashmë pothuajse bashkëjetojmë. Çdo herë që nëna ime është në Milano në atelier, unë jam në shtëpi tek ai. Dhe është mrekullia vetë.

- Hmm...

Por pse nuk është e bindur? A është e mundur që vërtet është e shqetësuar për studimet e mia? Është e vërtetë, vitin e kaluar nuk kalova testin për shkak të telasheve të dashurisë, por...

- A nuk të ka kaluar ndonjëherë dyshimi në mendje? - më pyet Ale. - Ndoshta të qëndrosh me dikë si Çezare nuk është zgjedhja më e mirë për ty. Unë kam pasur përvojat e mia me djemtë e këqij, dhe nuk ia uroj askujt ato.

- Nuk po e bën krahasimin e Danieleles me Çezaren, apo jo?

Alesandra tund kokën:

- Nuk po flisja për Danielen, e di që Çezare nuk ka asgjë të përbashkët me ish-in tim. Madje me asnjërin prej isha-ve të mi. Çezare është fantastik, e njohim prej kohësh, dhe e kuptoj që e do. Por edhe një djalë fantastik pas të cilit je e dashuruar kokë e këmbë, mund të jetë një përvojë toksike.

- Po!

Jam në siklet. Po ritakohemi pas shumë muajsh që nuk jemi parë dhe Ale s'përton të më kritikojë të dashurin. Ç'e gjeti vallë? Për herë të parë në jetë, ndihem si mbi gjemba me shoqen time të ngushtë. Dhe e keqja është që fjalët e saj fillojnë të më turbullojnë mendjen. Për shembull, këtë mëngjes Çezares i ishte errur krejt vështrimi nga epshi dhe problemet e tij, sa dukej sikur nuk po i interesonte fare provimi im. Ndërsa unë nuk vë pikë gjumi në sy natën, për të kuptuar se çfarë po kalon këtë periudhë.

Por këto arsyeime nuk do të më vijnë aspak në ndihmë për të studiuar.

- Vazhdon të takohesh me Lukën?

I ngrita sytë drejt Ales, që ka vënë në vend librin e biologjisë dhe më buzëqesh. - S'iu besova veshëve kur më tha që po shoqëroheshit përsëri. Mes jush gjërat përfunduan mos më keq!

Ato fjalë të Alesandrës më shpien pas në kohë, në urën Ostia, në një mbrëmje fundgushti të vitit të kaluar. Dritat e qytetit pasqyroheshin mbi detin e

errët, si një përshpirtje me qirinj. Kisha veshur bluzën e Lukës me shkronjën “S” të Supermenit, dhe aroma e ngjitur pas materialit, aroma e tij, përzihej me erën e kripur të ujit. Ma kishte dhënë bluzën, sepse ndieja ftohtë. Në shenjë falënderimi, i thashë që do të ndahesha prej tij. Ia theva zemrën, e di: Luka i ka sytë aq të çelët, sa ngajjnë si prej kristali, por lotët arrita t’i dalloja gjithsesi.

Kafshoj buzën.

- Në fakt, prej ca kohësh kemi nisur të shihemi përsëri, e nuk kemi hequr më dorë nga kjo.

- Sa mirë! - i përplas duart me gëzim Alesandra, e për një hop ngjan sikur jemi ende në gjimnaz, duke bërë thashetheme për djemtë gjatë pushimit të madh.

- Mora vesh që tani luan futboll në Serinë A. Jo keq!

- Tamam!

- Mendo pak sikur të bëhet si Kristiano Ronaldo! E ke idenë sa fiton Ronaldo? Luka është një zgjedhje e shkëlqyer!

- Ale! - ia shtyj gjurin e këmbës që mban sipër tjetrës. - Do ta lësh me kaq tani? Vitin që shkoi lëvize qiell e tokë bashkë që të rilidhesha me Çezaren, ndërsa tani dashke të më hedhësh në krahët e Lukës? Ç’te gjeti kështu?

Alesandra ngërdheshet, por këtë radhë e qeshura nuk është e sinqertë, por vetëm një mënyrë për të fshehur sikletin. Po silltet shumë më ndryshe nga zakonisht: duket si Alesandra e përherëshme, por nuk është kështu. Është njëlloj sikur të provosh të ndryshosh recetën e gatimit të pastave “Maritoci”:

po t'i shohësh së jashtmi e t'iu marrësh erë të duken njëlloj, por pastaj e kafshon një herë dhe e dallon që kremi shantili nuk është i njëjti.

Shoqja ime shfryn ajrin nga mushkëritë: - Të kërkoj ndjesë, por e kam sepse kam kaluar disa përvoja që më kanë ndryshuar së brendshmi. - Lëviz një tufëz flokësh nga fytyra në formë zemre. - Më kanë ndryshuar shumë.

Ja ku dolën prapë në dritë këto përvoja të mistershme. Jam kureshtarë, por ajo nuk ngjan se do që të futet në detaje. Ndoshta po ta marr si larg e larg...

- Përvoja që të kanë ndryshuar... Djem, apo jo? Megjithatë nuk bëhet fjalë për Xhorxon. Me atë s'iu kapi as Krishtlindja!

Ale ngre supet. Është jashtëzakonisht e bukur, vishet në mënyrë të përkryer, e mban përherë trupin e saj në formë. Dashurinë e jeton si një garë mes gocash, ku ajo duhet të dalë e para. E nëse për të arritur suksesin do t'i duhet që të shqelmojë zemrën e ndonjë ithtari, këtë s'e quan aspak problem. Sidomos pas asaj që i bëri Daniele në vitin e fundit të gjimnazit.

- Xhorxo ishte magjepsës, - më thotë, - por filozofët me kalimin e kohës bëhen të mërzitshëm.

- Posi, kurse futbollistët nga ana tjetër...

- Të paktën ata janë të krimbur në para. Pastaj...
- Ale më buzëqesh tinëzisht. - Lëri këto, të ka rënë edhe ty në sy sa i bukur është Luka. E ka trupin si statujë! Mos më thuaj që nuk kënaqeshe në krevat me një tip të tillë...

- Mund të kesh ndryshuar, vërtet, por mua prapë më dukesh si Alesandra e ndezur e gjimnazit. Je më keq se djemtë.

- Pa shiko kush po më bën moral!

Qeshim sërish të dyja dhe tensioni zbutet mes nesh. Tipat që ruajnë biçikletat kthehen drejt nesh. Po, po qeshim me të madhe, por kjo është e mira kur ke një shoqe të ngushtë: kur argëtohesh me të s'të plas fare ç'mendojnë të tjerët.

- Ku e lamë? Po më thoshe që po takohesh prapë me Lukën! - Ale merr pamjen e naives së pafajshme.

- E vë me bast që Çezare nuk është aspak i kënaqur nga kjo gjë. Po ka mbetur i njëjti, habitem që akoma nuk ia ka bërë përshesh turinjtë.

- Çezare e di që unë dhe Luka jemi vetëm shokë tani, - them duke përdredhur një tufëz flokësh përçark gishtit tregues. - Ka besim tek unë.

- Kur e thua ti...

Fytyra e Ales, pas shakasë, m'u duk se mori një pamje deri diku të shqetësuar. Po, e di, Çezare nuk tregohet i përmbajtur kur bëhet fjalë të përdorë dhunë, por edhe kjo e ka një kufi. Por më kot, shoqja ime gjatë këtyre muajve e paska bindur veten që ai nuk është djali i duhur për mua. Po edhe sikur të jetë kështu? Dashuria nuk njih arsyë dhe mes meje e Çezares ka dashuri të vërtetë.

- Dëgjo, s'dua të ngul këmbë. - Ale më sheh në sy. - Ke gjithë të drejtën e botës të rrish me djalin që preferon, mirë?

- Faleminderit për lejen e dhënë, Shkëlqesia juaj!

Ale shpërthen në gaz, një e qeshur e pastër, që të nxit dëshirën të qeshësh me të.

Një mendje më shtyn ta bind që e ka gabim për Çezaren. Mjaft që t'i tregojta fotografitë, ato dhjetëra foto që kam në celular dhe që përjetësohen me trëndafila të rinj të skalitur tatuazh në kraharor. Mjaft që t'ia shpjegoja kuptimin e atyre trëndafilave. Por, me pakëz trishtim, jam e vetëdijshme që Alesandra nuk do të kuptonte. Pastaj, po t'i tregojta atë punën e të nxirave në trup apo melankolinë që dallova të rishfaqej në sytë e Çezares, do të më shtynte që të ndahesha prej tij. Nuk kisha pasur kurrë probleme t'i hapja zemrën shoqes sime të ngushtë...

Ale shtyhet kah meje dhe më përqafton, në një shtrëngim edhe më të fortë se pak më parë.

- Ç'po e vrasim mendjen për çunat! Jam e lumtur që të takova përsëri!

E përqafoj dhe unë.

- Ale, je e çuditshme, vërtet. Çdo gjë në rregull me ty, apo jo?

- Po, besoj se po, - ajo i shkëput krahët nga unë dhe më buzëqesh. - Por nga tani e tutje, i dashuri yt dhe futbollisti engjëllor, duan të na ndajnë.

- Që ç'ke me të, se po ndodhi që të më zhdukesh përsëri nga sytë, kësaj here do të vij unë të të kërkoj...

#xhelozimëçokudoti #fytyrëengjëlli

Çezare e mban timonin me gishtat e shkrifët, ndërsa dorën te marshi e ka të shtendosur. Nuk lëviz asnjë muskul. Tipi me makinën e vogël prapa nesh nis të shtypë fort burinë, por i dashuri im duket sikur s'ka ndërmend ta lëvizë *BMW*-në e tij qoftë dhe gabimisht. E ka përsëri atë pamjen e engjëllit, sikur s'e di unë që kjo është veç një maskë pas së cilës fshihet demoni.

E qëlloj lehtas me grusht në krahun muskuloz.

- Ej, shiko që semafori ka kohë që është bërë jeshil, - dhe bëj me shenjë nga semafori që na shtyu të ndalonim. - Ja, tani u bë i verdhë, nis!

- Ops... - Çezare kthehet drejt meje dhe më buzëqesh, gropëza në faqe shpërfaq anën e tij të eksituar djallëzisht. - Nuk kalohet rruga me semafor të verdhë, kodi rrugor është i qartë për këtë. Si qytetarë korrektë që jemi, do të presim sa të bëhet jeshil përsëri!

Shfryj dhe e lëshoj veten pas sediljes prej lëkure, ndërsa pas nesh shumëfishohen jehonat e borive. Çezare bëhet i padurueshëm kur sillet në këtë mënyrë.